



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ARSIMIT SPORTIT DHE RINISË  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR  
DREJTORIA RAJONALE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR DURRËS

Nr. 1255/Prot.  
12

Durrës, më 16.06/2021

**NJOFTIM**

**MBI**


**AFATET E PRANIMIT TË DOKUMENTACIONIT PËR KANDIDATËT E PORTALIT "MËSUES  
PËR SHQIPËRINË" 2021**

Në zbatim të Udhëzimit nr. 12, datë 10.06.2021 "Për procedurat e pranimit e të emërimit të mësuesit në një vend të lirë pune në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar dhe për administrimin e portalit "Mësues për Shqipërinë" 2021, ju bëjmë me dije si më poshtë:

- 1- Dokumentacioni sipas Shtojcës 1, të Udhëzimit nr. 12, do të dërgohet në rrugë postare në adresën e DRAP Durrës, brenda datës **25.06.2021**.
- 2- Kandidati duhet të aplikojë online në portalin **mesuespershqiperine.al** deri me datë **25.06.2021**. Kandidati ngarkon në platformën e aplikimit online dokumentet për konkurrim.
- 3- Një kopje e dokumentacionit të ngarkuar online, për efekt të vlerësimit të dosjes e dërgon në DRAP-në ku ka qendrën e banimit.
- 4- Kandidati, dosja e të cilit nuk përmban dokumentat e detyrueshme për t'u ngarkuar online sipas shtojcës 1, nuk kalon në fazën tjetër të konkurimit.

**SHTOJCA 1**

1. Jetëshkrimi, (dorëzohet në momentin e punësimit)
2. Kërkesa me shkrim për konkurim sipas modelit të shtojcës 4 të udhëzimit nr.12, datë 10.06.2021
3. Kopje e kartës së identitetit (e detyrueshme për tu ngarkuar online).
4. Raport mjeko-ligjor (i tre muajve të fundit dorëzohet në momentin e punësimit)
5. Vetëdeklarim për gjendjen gjyqësore sipas shtojcës nr.5 të këtij udhëzimi (dorëzohet në momentin e punësimit)
6. Vërtetim i qendrës së banimit (i detyrueshëm për tu ngarkuar online).
7. Kopje e librezës së punës (nëse ka, për tu ngarkuar online).

- 
8. Kopje e diploms/ave, vërtetimit/listës së notave të studimeve të larta (cikli i parë dhe i dytë) ose të barasvlershmive me këto sipas përcaktimeve të kuadrit ligjor në fuqi **(i detyrueshëm për tu ngarkuar online)**
  9. Kopje e licencës së provimit të shtetit për profesionin e rregulluar të mësuesit, për të gjithë kandidatët që kanë detyrim ligjor ta kryejnë këtë provim sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi **(i detyrueshëm për tu ngarkuar online)**.
  10. Kopje e dëshmimeve të kualifikimit për kategoritë: “Mësues i kualifikuar”, “Mësues specialist”, “Mësues mjeshtrë” **(nëse ka, për tu ngarkuar online)**
  11. Kopje e certifikatave me kredite të trajnimeve të kryera brenda dhe jashtë vendit. Certifikatat me kredite të trajnimeve të kryera Brenda vendit të jene ofruar nga MASR, institucioet e varësisë ose nga agjencitë e akredituara nga MASR **(nëse ka, për tu ngarkuar online)**.
  12. Kopje e dëshmisë së njohjes së gjuhës/vet ë huaja (nëse ka për tu ngarkuar online)
  13. Deklarim nga kandidati për autorizimin e DRAP-së që të shqyrtojë vërtetësinë e dokumentave të paraqitura sipas shtojcës 6 të Udhëzimit nr.12, datë 10.06.2021 **(i detyrueshëm për tu ngarkuar online)**

**NUK DO TË PRANOHEN ANKIMIME NËSE DOKUMENTACIONI NUK KA ARDHUR NË RRUGË ZYRTARE BRENDË AFATEVE**

**Shënim:** Dokumentet që ngarkohen në platformën e aplikimit online, janë të skanuara nga origjinali

DIREKTOR

Ana DHAMO

